

DANAIL SULKU

APOLOGJIA E MBRËMJES

POEZI

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktore letrare: Besa Vila

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Kopertina *dhe* përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817082

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Shqiptar

Çoç e burrë luaj vendit,
Jargët lumë i shkojnë kuvendit!
Mavijosur shalë përjashta,
Tyt, me ndere përpjetë ashta!

Luaj vendit, hë, teveqel,
Mblidhen shqipet në bordel,
Ligje thurin, kanune mbesin,
Mbi fletushka të tërë dhjesin!

Çoç e burrë e na pri,
Rrugën tonë Ti, na ndri!
Se haram e pehlivanë,
Dergjet kombi anembanë!

Çoç e burrë Naltmadhëri,
Për Europë po na shpie Ti,
Katandisur e vrerosur,
Kurvëruar e dreqosur!

Çoç e burrë e sitkërrusu,
Bythëlëpirës Ti, krekosu!
Me të tillë hajna e fundërrri,
Kurrë s'do të ketë Shqiptari!

APOLOGJIA E MBRËMJES

Atdheu im

I ngushtë, oh sa i pamat,
Bëmë dhe mua një grimë vend,
Një qoshkëz
Të fle e zgjohem një çikë shqiptar!

Dhe mua të më ndukë një rreze drite,
Vetëm hone po më zgjat
Si kthetra merimange babëzitur,
Nursëz të zinj e baloshë.

I ngushtë, oh sa i pamat,
Tregomë dhe mua nëse jam shqiptar!
Sytë po më dhëmbin,
Shpirti po më thyhet teksa shoh
Pushta e pizevengë fytyrëzgjerdhyer.
Çapojnë
Të të ngulin kthetrat sa të mundin,
Gjakun të ta thëthijnë
Jetën po ma mynxyrin!

Atdheu im, i ngushtë, i acartë,
Tregomë nëse jam biri yt i devotshëm,
Apo këta vagabondë që po ta shkojnë hanxharin në
fyt
Po na i quan heronj!
Edepsëzë pa din e iman, sojli
Pushta e bij pushtash tradhtorë
Po ta mësyjnë lirinë e po ta, nxijnë bukurinë.

Atdhe i ngushtë, mërdhij,
Lëshomë rrezen e dritës,
Mos më mbaj në errësirë!

Apologjia e mbrëmjes

Ç'është ky diell që po shndrin?!
Terrin tim po e përpin...
Pizevengu komunist,
Doç i doçëve, Ti, ballist!

Se përbuzur nëpër mote,
Perëndoi koha jote!
Troku im furtunë beteje,
Më vlon gjaku nëpër deje.

Lot e gjak, dhunë e përdhunë,
Shpagoj ditën që më përzunë.
Dhëmbë çakalli, thonj shqiponje,
Fole bishe, fole zgërbonje!

Porse dielli do të shndrijë,
Atavizmin të përpijë.
Pizevengu komunist,
Doç i doçëve, Ti, ballist!

Peizazh

Vatën, shqiptarët e burrërisë,
Mbi njëri-tjetrin vështtrimin mprehur.
Çarkun ngrehur, llërat mbrehur,
Harkun mësyer në sy të vëllazërisë!

Vatën, shqiptarët e burrërisë,
Shqyer frerët e lirisë!
Si çetnik sulur mbi bedena,
Shprishur gjakun nëpër vena.

Vatën, shqiptarët e burrërisë,
Vrer e tmerr i tiranisë!
Shqiptarët e besës dhe idealit,
Të Ilirisë e Skënderit!

Ejani shqiptarë, bekim i Zotit!
Si në kohën e Kastriotit,
Besa, besë në bashkim,
Të gjithë bashkë në marshim!

Gjoksin lart, radhët ngjeshur,
Me epokat zjarr kërleshur.
Rreth flamurit-Ideal,
Për bashkimin kombëtar!

Thrak

Unë jam thrak,
Për nga fisi jam Arban,
Për nga soji jam kaçak.

Unë jam thrak,
Po më ngave në nder, besë e gjak,
Ta shtroj udhën tym e flakë.

Unë jam thrak,
Herë i ëmbël e zemërak,
Jam i kohës, dredharak.

Unë jam thrak,
Për nga soji jam kaçak,
Ta ndez zjarrin bubulak!

Unë jam thrak,
Burrë zakoni e adapt,
Ngre flamurin në konak!

Lundërtar

Lundërtar i vogël, ti,
Mbrehi velat për veri.
Rrumbullak pikë-pikë,
Rreth globit për Arktikë.

Lundërtar i vogël, ti,
Harabeli mbi çati.
Larg folezës sillesh ti,
Bashkudhëtar në gjithësi.

Lundërtar i vogël, ti,
Lësho varkëzën në pellg,
Timonier mbi direk,
Vështro botën pa hendek.

Pikë-pikë ti, je det,
Kujtim i vogël siç je vetë.
Lundërtar i vogël, ti,
Harabeli mbi çati.

Parodi

Ta ngremë dollinë,
E paçim partinë!
Balo ziu ballisti,
Kuqo, ti, komunisti!

Një dolli për kryetarin,
Triumfuesin në betejë,
Një dolli për qytetarin,
Euforia të shpërthejë!

- Të na rroç sa malet!
Kupat plot e shëndet.
- Kapedane, ty, të kemi,
- T'i na prij e ne ngrihemi!

Ta ngremë dollinë,
Gjer në përjetësim!
Balo ziu ballisti,
Kuqo ti, komunisti.

Me shëndete të pasojmë,
Na shndrit fytyra kur fitojmë!
Shtyp e shtrydh njerëzinë,
Rrokopujë Shqipërinë..

Balo ziu ballisti,
Kuqo ti, komunisti.

Fjalëz

Cjapi prijës mblodhi kopenë,
Dy-tri gjëra duhen thënë.
Që të jemi bashkë e të bashkuar,
Asnjë ftujkë s' duhet ngacmuar!

Të ruajmë nder e traditë,
Ligj po shpallim shkuesitë!
Dashuriçkat nuk lejohen,
Na prishin fisin, na ndotin farën!

Një nga një secili votoi,
Gjithë kopeja e miratoi.
Ndanë punët e ndanë detyra,
Të gëzuar u ndriste fytyra!